

Ditët e Orientimit Shqiptar 2020

Jemi të lumtur t'ju ftojmë në garën e katërt të orientimit në Shqipëri!

Nga data 23 deri më 26 Prill 2020 në Tiranë

Gara Ndërkombëtare 3 ditore e Orientimit në rajonin e Tiranës, Shqipëri

Organizator: Klubi i Orientimit Tirana "KLOT"

Drejtuesi i garës: Menduh Zavalani (Shqipëri)

Menaxheri i garës: Inge Bosina (Shqipëri/Austri-Naturfreunde Wien)

Hartë bërësi: Ondrej Pijak, Valter Soler (Sllovakia); Inge Bosina

Planifikuesi i kursit: Wolfgang Pötsch (Austri)

Qendra e garës: Tiranë, Shqipëri (më shumë detaje në njoftimin e dytë)

Programi paraprak:

E Enjte, 23 Prill 2020

Mbërritja, regjistrimi, sistemimi, mundësia e stërvitjes

Qendra e garës e hapur nga 12:00 deri në 21:00

E Premte, 24 Prill 2020

9:00-12:00 Qendra e garës është e hapur

13:00 Pika e takimit në Malin e Dajtit, në stacionin e teleferikut në mal

14:00 Nisja e parë në distancë të mesme

E Shtunë, 25 Prill 2020

11:00 Qendra e garës hapet tek Kepi i Rodonit

12:00 Nisja e parë në distancë të gjatë

E Diel, 26 Prill 2020

10:00 Nisja e parë sprint në Qytetin Studenti, Tiranë

13:00 Ceremonia e dhënies së çmimeve

Sponsor:

	Logoja Juaj	Logoja Juaj
---	-------------	-------------

Kategoritë e garuesve:

- M10, M12, M14, M16, M18, M20, M21E, M21A, M21B, M35, M40, M45, M50, M55, M60, M65, M70, M75+
- W10, W12, W14, W16, W18, W20, W21E, W21A, W21B, W35, W40, W45, W50, W55, W60, W65, W70, W75+
- Open 1 (I vështirë), Open 2 (mesatar), Open 3 (fillestar)
- Kursi i fëmijëve (pa pagesë)

Në rast të regjistrimit të një numri të vogël, organizuesi mund të bashkojë disa kategori.

Tarifat e garave: sipas afateve të regjistrimit dhe kategorive, si më poshtë:

Kategoritë	Regjistrimi deri		
	17 janar 2020	20 Shkurt 2020	10 Prill 2020 - Afati i fundit
M/W -16	16 EUR	22 EUR	26 EUR
	5 EUR/ gara	7 EUR/ gara	9 EUR/ gara
Open	20 EUR	28 EUR	35 EUR
	6 EUR/gara	9 EUR/gara	12 EUR/gara
M/W 18+	35 EUR	50 EUR	65 EUR
	12 EUR/ gara	17 EUR/ gara	22 EUR/ gara

KUJDES: Tarifa e hyrjes përfshin transportin me teleferik për në Dajt vajtje-ardhje. Për ata që duan të marrin pjesë vetëm në garën e Malit të Dajtit pagesa është + 5€ për transportin (jo për ata me akomodim në hotel në Dajt).

Shënime:

- Pas afatit të fundit është e mundur të regjistroheni vetëm në kategoritë "Open" me një kosto 15€ për garë. Në të gjithë kategoritë e tjera, vetëm në rast se ka disponibilitet me kosto 25€ për garë.
- Për shtetasit shqiptarë, për më tepër informacion mund të kontaktoni në e-mailin info@orienteering-al.com Çmimet do të jenë të arsyshme dhe për anëtarët e klubeve shqiptare të orientimit do të ketë çmime të reduktuara.
- Sistemi i vulosjes: Sport ident, SI-qira 2€ per garë, çmimi për blerje sipas kërkesës.
- Kujdesi ndaj fëmijëve: do të organizohet një kopsht falas, gjithashtu dhe një kurs për fëmijët.

Ju lutem të bëni regjistrimet online në faqen:

<http://www.orienteeringonline.net/CompetitionBasicInfo.aspx?CompetitionID=4662>

Regjistrimi do të konfirmohet pas pagesës. Pagesa duhet të bëhet me transferim në llogarinë:

IBAN: AT061200010009245571, BIC: BKAUATWW

Emri: BOSINA Inge

Adresa: Sandleitengasse 37, 1160 Wien, Austria

Ju lutem dërgojeni pagesën me komisione të paguara (pa shpenzime për organizuesin), përndryshe jemi të detyruar t'ju ngarkojmë ato kur të mbërrini.

Në rast se keni nevojë për mundësi të tjera pagese, ju lutem të kontaktoni:

info@orienteering-al.com

Viza: shtetasit e Komunitetit Evropian dhe pjesa më e madhe e shteteve evropiane nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në Shqipëri, përfshirë dhe ata që kanë një vizë me shumë hyrje e dalje në zonën Shengen. Për ata që vijnë nga shtete të tjera, kontrolloni listën e mëposhtme:

<http://punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2019/03/2-regjimi-i-vizave-per-te-huajt06.03-1.pdf>


Për detaje të mëtejshme shikoni informacionin në faqen e internetit të Ministrisë së Jashtme Shqiptare:

<https://punetegashtme.gov.al/en/regjimi-i-vizave-per-te-huajt/> ose kontaktoni Ambasadën shqiptare në vendin tuaj.



Mbërritja:

- **Me avion** në Tiranë, Aeroporti Ndërkombëtar „Nënë Tereza“ (17 km nga qendra e Tiranës)
- **Me makinë:**
 - nga Mali i Zi – pikat doganore Vermosh, Hani i Hotit, Muriqan
 - nga Kosova – pikat doganore Qafë Prush, Morinë, Qafë Morinë
 - nga Maqedonia e Veriut – pikat doganore Maqellarë, Qafë Thanë, Tushemisht
 - nga Greqia – pikat doganore Kapshticë, Tre Urat, Kakavijë, Qafë Botë
- **Me anije:**
 - nga Italia (Trieste, Ancona, Bari, Brindizi) për në Durrës dhe Vlorë
 - nga Greqia (Korfuz) për në Sarandë
- **Me tren:** Shqipëria lidhet me Malin e Zi me rrjet hekurudhor vetëm për transport mallrash, por nuk ofron shërbim ndërkombëtar për pasagjerë. Gjithsesi mund të udhëtoni me tren në linjat e brendshme: Shkodër-Tiranë-Vlorë, Tiranë-Durrës-Librazhd



Distancat: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës – Tiranë qendër 17 km

Tiranë – Terminali i Teleferikut në Dajt 5 km

Tiranë – Këpi i Rodonit 60 km

Informacione të përgjithshme:

- Sport Ident do të përdoret si sistemi i vulosjes. Ju lutem të jepni numrin e kartës SI në momentin e regjistrimit.
- Garat do të organizohen në përputhje me rregullat e IOF.
- Të gjithë garuesit marrin pjesë në garë nën përgjegjësinë e tyre të plotë; organizuesi ofron vetëm ndihmën mjekësore bazë në mbërritje. Pjesëmarrësit nuk sigurohen nga organizuesi, për dëmet që u shkaktojnë vetvetes ose personave të tjerë. Rekomandohet siguracioni individual.
- Në rast të anulimit të garës për motive që nuk lidhen me organizuesin, organizimi nuk mban asnjë përgjegjësi.
- Të gjithë garuesit e regjistruar janë automatikisht dakord me publikimin e fotove të tyre gjatë evenimentit dhe të rezultateve në faqen e internetit. Përndryshe, ju lutemi të informoni organizuesit në momentin e regjistrimit.
- Ju lutemi të lexoni me kujdes të gjithë informacionin e organizmit dhe atë që përmban ky njoftim.


Shembuj terreni:

Terreni ditën e parë: Distanca e mesme

Mali i Dajtit

Vendndodhja do të jetë pranë terminalit të teleferikut, në Fushën e Dajtit, një pllajë rreth 1050 m mbi nivelin e detit.

Pyjet e dendura të ahut që mbulojnë dy majat e Dajtit rrethojnë dhe terrenin e garës. Relievi ofron shtigje me pjerrësi të ndryshme, ndërsa në disa vende shkëmbinj të thepisur rrethojnë terrenet e ndryshme, gjysmë të hapura dhe të hapura, me mundësi shumë të mirë vrapimi.



Dajti Tower Belvedere Hotel

Terreni ditën e dytë: Distanca e gjatë

Kepi i Rodonit

Është një gadishull mjaft i bukur që rrethohet nga Deti Adriatik. Terreni është i hapur dhe gjysmë i hapur, me mundësi të mira vrapimi, por edhe pjesë me shumë bimësi të dendur, pyje, humnera të thella (jo për vrapim!) me pamje madhështore mbi det. Në këtë fazë ju duhet të kujdeseni për të mos harruar pamjet befasuese që do të keni gjatë garës. Zona finale do të jetë tek plazhi. Në të njëjtën kohë, ju mund të mësoni rreth historisë së Shqipërisë në një kishë të shekullit 15-të dhe rrënojat e kalasë së Skënderbeut.



Zona e finishit

Terreni ditën e tretë: Sprint

Qyteti Studenti, Tiranë

Kjo garë do të jetë për këdo që pëlqen sfidën e garës në sprint.

Kjo pjesë e Tiranës përbëhet nga një përzierje ndërtesash që nga koha e komunizmit dhe ndërtesa më të reja, të lidhura me një labirint rrugësh, shpesh duke mbaruar në hapësira të hapura pa ndërtesa dhe rrugë qorre. Ndodhet gjithashtu pjesa e universitetit dhe konvikteve me blloqe të mëdha dhe parqe.



Në labirint të Qytetit Studentit



Zona e Finishit

Paketat:

Për ta bërë sa më të lehtë dhe të mundur pjesëmarrjen tuaj, kemi përgatitur disa oferta të plota me çmime ku përfshihet tarifat e garave, transfertat, akomodimi, mëngjeset, dhe udhëtimet për ta njohur më mirë Shqipërinë.

Paketat bazë për akomodimin në Tiranë janë si më poshtë.

Çmimi përfshin:

- Tarifën e garës
- Transportin nga Aeroporti në akomodimin tuaj dhe anasjelltas, si dhe tek zonat e garës.
- 2 netë në hotel sipas kategorisë së zgjedhur
- Mëngjesin

Kategoritë	Çmimi i paketave	Shtesa për dhomë teke
Hotel me 4 yje	€ 190 / person	€ 80,00
Hotel me 3 yje	€ 130 / person	€ 40,00
Hostel	€ 95 / person	

Çmimet janë të vlefshme deri në fund të rregjistrimit të parë (17 janar 2020), në të kundërt tarifat do të jenë sipas pagesës së hyrjes.

Paketa në hotele me 5 yje, si dhe akomodimi në vende të tjera, si p.sh. në bregdet sipas kërkesës.

Për grupe ne do të bëjmë një paketë speciale.

Programi Turistik:

Përveç këtyre paketave themelore, ne ofrojmë dhe udhëtime nëpër Shqipëri. Me kënaqësi mund të organizojmë për ju një udhëtim të personalizuar sipas dëshirës, duke përfshirë destinacione të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, vende arkeologjike dhe historike ose ecje në mal, pushime në plazh dhe vizitën e pikave me interes të veçantë. Turet do të drejtohen nga guida profesioniste të licensuara dhe arkeologë të njohur.

Më shumë informacion në lidhje me ofertat e tjera do të gjeni në faqen tonë të internetit.

website: <http://orienteering-al.com>

Mail: info@orienteering-al.com

Ju falenderojmë që keni kontribuar në “Projektin e Orientimit Shqiptar”
me pjesëmarrjen tuaj!

Mirë se erdhët në Shqipëri!